



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1649 / 12 Prot.

Patos, më 19.05.2026

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Patos.

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Patos.

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Fier.

Kryetarit të Bashkisë Patos.

Në zbatim të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2 germa (a) të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ju njoftojmë se ditën e premte datë 29.05.2026, ora 14⁰⁰, në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Patos do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Patos, me këtë rend dite:

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.04.2026.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.04.2026.
- 4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2026”.
- 5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2026”.
- 6- Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për z. Pëllumb Bendaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja “E Re”.
- 7- Projekt-vendim “Për miratimin e “Raporti Vjetor i konsolidimit të zbatimit të buxhetit dhe i Performancës për vitin 2025”.
- 8- Projekt-vendim “Për një ndryshim të vendimit nr. 04, datë 30.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026”.
- 9- Projekt-vendim “Për disa ndryshime në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave në bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026”
- 10- Projekt-vendim “Për shtim të dy punonjësve sezonal për masat parandaluese nga zjarri në pyje”.
- 11- Projekt-vendim “Për një ndryshim në V.K.B nr. 21, datë 29.03.2024 “Për miratimin e Programit të Transparencës në bashkinë Patos.
- 12- Informacion mbi raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2026.

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

Komisioni i Ekonomisë, Financës dhe Ndhimave Ekonomike do të shqyrtojë pikat
4,5,6,7,8,9,10



KRYETARI
Armand Ahmetaj